



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGETIKES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLITIKAVE TE ZHVILLIMIT TE BURIMEVE  
NATYRORE  
DREJTORIA ENERGETIKE

Nr. 6453 Prot.  
18

Tiranë, më 18/10/2010

Drejtuar: **Zotit Gjergj THOMAI, DREJTOR EKZEKUTIV**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE**  
Blloku "Vasil Shanto"

**TIRANE**

**Lenda:** Dergohet rregullorja per funksionimin e grupit "Per kryerjen e Oponences Teknike te projekteve te ndertimit te hidrocentraleve me koncesion ne AKBN"

Ne pergjigje te shkreses tuaj me nr.2529, dt.22.09.2010, "Dergohet per mendim projekt rregullorja per funksionimin e grupit per kryerjen e oponences teknike te projekteve te ndertimit te hidrocentraleve me koncesion ne AKBN", po ju dergojme bashkelidhur kete rregullore, ne te cilen jane reflektuar mendimet e METE-s.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

**SEKRETARI I PERGJITHSHEM**

**DURIM KRAJA**



MIRATOHET  
ZEVENDESKRYEMINISTRI,  
MINISTRI I EKONOMISE, TREGTISE  
DHE ENERGJETIKES



RREGULLORE

PER  
FUNKSIONIMIN E GRUPIT "PER KRYERJEN E Oponences teknike te  
PROJEKTEVE TE NDERTIMIT TE HIDROCENTRALEVE ME KONCESION"  
NE AKBN

Ne mbështetje te pikes 3 te VKM nr.547, date 09.08.2006 " Per krijimin e Agjencise Kombetare te Burimeve Natyrore", te ndryshuar, hartohet rregullorja " Per funksionimin e grupit per kryerjen e oponences teknike te projekteve te ndertimit te hidrocentraleve me koncesion, ne AKBN".

Neni 1  
Qellimi

Kjo rregullore ka per qellim ngritjen dhe funksionimin e grupit per kryerjen e oponences teknike te projekteve te ndertimit te hidrocentraleve me koncesion, ne AKBN si dhe percaktimin e procedures qe do te ndiqet per kryerjen e oponences teknike.

Neni 2  
Perkufizime

Ne kuptim te kesaj rregulloreje, termat e meposhtem kane keto kuptime:

**-Oponence teknike per studimet e fisibilitetit**

Eshte vleresimi tekniko-mjedisor i projekt-propozimimeve per ndertimin e hidrocentraleve me koncesion, paraqitur nga personat fizike apo juridike, private, te huaj apo vendas, duke synuar shfrytezimin optimal te burimeve ujore.

**-Oponenca teknike per projektet e zbatimit te hidrocentraleve**

Eshte kontrolli dhe vleresimi mbi zbatimin e Kushteve Teknike te Projektimit per ndertimin e hidrocentralit, ne plotesimin dhe saktesimin e te dhenave studimore, hidroenergjetike, -gjeologo-inxhinjerike, hidrologjike e topo-gjeodezike, elektrike e mjedisore.

### **-Studim Fizibiliteti**

Është raporti dhe pjesa teknike e hartuar ne baze te specifikimeve ne Aneksin 1, bashkelidhur kesaj rregulloreje.

### **-Projekt zbatimi**

Eshte projekti teknik i detajuar, i cili eshte hartuar mbi bazen e studimit te fisibilitetit, i plotesuar me relacionin e pergjithshem teknik dhe materialet grafike, duke saktësuar te dhenat studimore, hidroenergjetike, gjeologo-inxhinjerike, hidrologjike e topo-gjeodezike, elektrike e mjedisore.

### **-Raport vleresimi i studimit te fizibilitetit**

Eshte raporti tekniko-mjedisor i hartuar nga anetaret e grupit te oponences teknike, sipas Aneksit 2 (bashkelidhur kesaj rregullore), qe del si rezultat i vleresimit perfundimtar nga ana e ketij grupi te studimit te fizibilitetit dhe qe i percillet METE-s.

### **-Raport vleresimi i projektit te zbatimit**

Eshte raporti teknik i hartuar nga anetaret e grupit te oponences teknike qe del si rezultat i vleresimit perfundimtar nga ana e ketij grupi te projektit te zbatimit dhe qe i percillet METE-s.

### **-Propozim i pakërkuar**

Është propozimi për te marre përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur ne përgjigje të një kërkesë te bere nga autoriteti kontraktues, brenda kontekstit te një procedure përzgjedhëse konkurruese.

### **-Propozim i kërkuar**

Është propozimi për te marre përsipër projekte koncesioni, i cili ka ardhur ne përgjigje të një kërkesë te bere nga autoriteti kontraktues, brenda kontekstit te një procedure përzgjedhëse konkurruese.

### **-Autoriteti Kontraktues:**

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

### **-Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)**

Eshte enti publik ne varesi te Ministrit te METE, i krijuar me VKM nr.547, date 09.08.2006 te ndryshuar, i cili siguron brenda fushës së veprimtarisë së vet oponencën teknike për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë energjetike, si dhe bashkëpunon me Autoritetin Kontraktues për përgatitjen e dokumentacionit teknik për

projekt propozimet e kërkua dhe të pa kërkua. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar.

### Neni 3

#### **Objekti i veprimtarisë, ngritja dhe funksionimi i grupit për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN**

1. Grupi për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion është organ kolegjal, vendim-marrës i përhershëm që krijohet në AKBN, në zbatim të pikës 3, të VKM nr.547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore".
2. Me kërkesë të Autoritetit Kontraktor grupi kryen oponencën teknike për studimet e fizibilitetit për çdo projekt propozim dhe për projektet e zbatimit të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion, që paraqiten nga subjekte private vendas dhe të huaja.
3. Grupi për kryerjen e oponencës teknike të jetë me 9 anëtarë dhe të ketë këto përberje: Kryetari që është Drejtori Ekzekutiv i AKBN, një Nenkryetar dhe 7 anëtarë të tjerë. Grupi i oponencës teknike ka dhe një sekretar që është pa të drejtë vote, i cili caktohet nga Drejtori Ekzekutiv. Përberja e grupit teknik të oponencës teknike, propozohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN dhe miratohet nga Ministri. Ky grup duhet të ketë në përberjen e tij specialistet me të aftë të mundshëm, të atyre fushave për të cilat kërkohet dhenia e oponencës teknike.
4. Anëtarët e grupit të Oponencës Teknike, janë punonjës të AKBN-së. Anëtarët e grupit të Oponencës Teknike, janë punonjës të AKBN. Për specialitete të cilat nuk janë në strukturën e AKBN, apo për të cilat kërkohet një ekspertizë me profesionale, pranë grupit të OT, të punojnë edhe ekspertë jashtë strukturave të AKBN.
5. Numri i specialistëve të jashtëm dhe shpërblimi i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues të AKBN-së.

### Neni 4

#### **Detyrat e Grupit të Oponencës Teknike**

Grupi i Oponencës Teknike (OT):

1. Administron dhe shqyrton çdo kërkesë të paraqitur nga Autoriteti Kontraktues (METE), në bashkëpunim me të, për shfrytëzimin energjetik me koncesion të lumëve apo pellgjeve lumore. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës përcakton dhe informon Autoritetin Kontraktues (METE) nëse ky lum apo pellg lumor është i lirë dhe mund të shfrytëzohet me koncesion apo jo.
2. Vepron për projekte të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues (METE).
3. Kryen oponencën teknike për çdo projekt-propozim (studim fizibiliteti) që paraqitet nga subjektet në METE.
4. Kryen oponencën teknike për çdo projekt-zbatim, për ndërtimin e hidrocentraleve me koncesion, që paraqitet nga subjektet në METE.

5. Pas perfundimit te oponences, sipas pikave 2 dhe 3 më siper, grupi harton raportet perkatese te vleresimit dhe së bashku me projektet përkatëse i përcjell ato në METE.
6. Përgatit në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Autoritetit Kontraktues dokumentat teknike të projekteve të paraqitura sipas procedurës për propozimet e kërkuara.

#### **Neni 5**

#### **Detyrat e Sekretarit te grupit te oponences teknike**

Sekretari i grupit te oponences , ka keto detyra :

1. Terheq te gjithë materialet e depozituara ne protokoll, te cilat do te shqyrtohen nga grupi i oponences;
2. Ve ne dispozicion te anetareve te grupit materialet e tërhequra nga protokollu dhe qe do te shqyrtohet ne mbledhje;
3. Mban Proces-Verbalin e mbledhjeve;
4. Ve ne dispozicion te grupit te oponences, sa here fillojnë procedurat e vlerësimit te një projekt propozimi te ri, listen qe disponon Drejtoria Hidroenergjetike, me bazen e të dhënave mbi emërtimet e lumenjve/përrenjve, lokalizimeve, si dhe te dhënat dhe parametrat kryesore teknike te çdo propozimi te miratuar, ne zonen ne shqyrtim.
5. Pergatit te gjitha njoftimet drejtuar subjekteve, projektet e te cileve kane ardhur ne AKBN nga METE per te kryer oponencen, per depozitimin e tarifes perkatese te kryerjes se oponences.

#### **Neni 6**

#### **Mbledhjet e grupit te oponences teknike**

1. Grupi i oponences teknike mblidhet normalisht 2 here ne muaj, ose sa here Drejtori Ekzekutiv e sheh te nevojshme, si dhe sa here i kerkohet nga Ministri i Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes, por gjithmone brenda kohes optimale per shqyrtimin e projektit;
2. Mbledhja e grupit do te zhvillohet kur ne te marrin pjese minimumi 6 anetare te grupit (2 specialist hidroteknike, 1 specialist gjeolog, 1 specialist hidrolog, 1 specialist elektrik, 1 specialist mjedisi).
3. Mbledhja e grupit kryesohet nga kryetari i tij dhe ne mungese te tij nga nenkryetari i grupit.
4. Ne mbledhjen e grupit te oponences, mbahet procesverbal ku pasqyrohet e gjithë procedura e kryerjes se oponences teknike. Proces-verbali i mbledhjes firmoset nga te gjithë anetaret e pranishem.

## Neni 7

### Procedura per kryerjen e oponences teknike te projekt-propozimeve (studimeve te fizibilitetit) dhe projekt-zbatimeve te ndertimit te hidrocentraleve me koncesion

1. Grupi i Oponences Teknike kryen vleresimin tekniko-mjedisor te projekt-propozimit, sipas Aneksit 1 dhe ne perfundim harton Raportin e Vleresimit, sipas Aneksit 2, bashkelidhur kesaj rregulloreje.
2. Grupi i Oponences Teknike kryen vleresimin teknik te projekt-zbatimit dhe ne perfundim harton Raportin e Vleresimit.
3. Kryetari i grupit te oponences teknike therret perfaqesues te studios se projektimit te projekt-propozimit, nese e sheh te nevojshme, ne varesi te llojit te projektit, per te prezantuar dhe mbrojtur projektin ne prani te Grupit te Oponences Teknike, ne ditën e caktuar per vleresim. Pas prezantimit dhe mbrojtjes se projekt-propozimit apo projekt-zbatimit, perfaqesuesesit e studios se projektimit, largohen dhe grupi i Oponences Teknike vazhdon punen per kryerjen e oponences.
4. Çdo anetar i grupit, perpara kryerjes se oponences teknike, duhet te deklaroje me shkrim qe nuk eshte ne konflikt interesi me kete procedure vleresimi.
5. Kur një anëtar i grupit te oponences teknike është projektues i projekt propozimit apo projekt-zbatimit qe do te vlerësohet, apo i projekt-propozimeve qe konkurojne me te, atëherë ai nuk do te marre pjese ne diskutimin dhe vlerësim te tij.
6. Ne rast se, grupi i oponences teknike verën se projekt propozimi apo projekt-zbatimi nuk eshte i plote dhe duhet rishikuar, brenda 15 diteve nga beria e vleresimit, me firme te Kryetarit te Grupit i njofton zyrtarisht, verejtjet per plotesim, subjektit qe ka paraqitur projektin,. Brenda 60 diteve nga marrja e njoftimit, subjekti duhet te plotesoje verejtjet dhe te depozitoje prane zyres se protokollit te AKBN-se, projektin e plotesuar sipas verejtjeve te grupit te oponences, ne dy kopje. Kopjet e projektit te plotesuar sipas verejtjeve dhe qe jane depozituar ne protokoll merren ne dorezim nga sekretari i grupit te oponences teknike, nje kopje te tyre ai e paraqet per shqyrtim ne mbledhjen e radhes ndersa kopja tjeter ne perfundim te vleresimit nga grupi i oponences teknike percillet se bashku me raportin e vleresimit ne METE. Me perfundimin e afatit 60 ditor, grupi i oponences teknike ne mbledhjen e rrades shpreh qendrimin perfundimtar ndaj projekt-propozimit apo projekt-zbatimit te paraqitur.
7. Kur per nje projekt-propozim apo projekt-zbatim, eshte e nevojshme te kryhet nje ballafaqim me perfaqesuesit e studios se projektimit te propozimit apo projekt-zbatimit grupi i oponences teknike organizon takimin dhe bazuar ne argumentat e sjella vendos perfundimisht qendrimin e tij lidhur me projekt-propozimin apo projekt-zbatimin ne fjale.
8. Ballafaqimi si pjese e procesit te vleresimit organizohet kur:
  - Kerkohet nga subjekti qe ka paraqitur projekt- propozimin apo projekt-zbatimin

- Kerkohe nga grupi i oponences teknike.

Ky ballafaqim kryhet kur marrin pjese:

- Anetaret e grupit te oponences, te cilet kane vleresuar kete raport
- Perfaqesuesit e studios se projektimit te ketij projekt-propozimi apo projekt-zbatimi
- Perfaqesues nga shoqeria investitore

9. Grupi i oponences teknike shpreh qendrimin e tij perfundimtar ndaj projekt-propozimit nepermjet raportit te vleresimit te studimit te fizibilitetit, sipas Aneksit 2, pjese e kesaj rregulloreje, i cili firmoset nga te gjithet anetaret e grupit te oponences teknike qe kane kryer vleresimin, si dhe ndaj projektzbatimit nepermjet raportit te vleresimit te projektzbatimit i cili firmoset nga te gjithet anetaret e grupit te oponences teknike qe kane kryer vleresimin.

10. Raporti i vleresimit sipas pikes 9 te kesaj rregulloreje mbahet ne 3 kopje, njeren prej te cilave e mban sekretari i grupit te oponences teknike ne AKBN, tjetra depozitohet ne protokollin e AKBN-se dhe kopja e trete i percillet Autoritetit Kontraktues (METE), me firme te Drejtorit Ekzekutiv te AKBN-se per vazhdim te metejshe me te procedures per identifikimin dhe vleresimin e nje projekti koncensionar ne rastin e projekt-propozimeve apo per vazhdimin e metejshe me te procedures per zbatimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kontratat koncensionare ne rastin e projekt-zbatimit te ndertimit te hidrocentraleve me koncesion.

11. Anetaret e grupit te oponences teknike duhet te ruajne konfidencialitetin e diskutimeve, vleresimeve te bera dhe te dheneve teknike te projekt propozimeve dhe projektzbatimeve te paraqitura bazuar ne nenin 24, te ligjit 9663 date 18.12.2006 "Per Koncesionet", te ndryshuar.

12. Nje mbledhje e grupit te Oponences teknike mund te behet kur marrin pjese 2/3 e anetarve. Projekti do te konsiderohet i pranuar kur ka marre votat e jo me pak se 6 anetarve. Ne rast se anetaret e grupit - specialiste hidroteknik dhe hidrolog, votojne kunder, projekti konsiderohet i pa miratuar.

13. Ne rast te konstatimit te konfliktit te interesit apo praktikave korruptive te anetareve te grupit te oponences teknike, kryetari i grupit te oponences teknike ka te drejte te kerkoje pavlefshmerine dhe perseritjen e oponences. Ne kete rast ne zbatim te nenit 3, te kesaj rregulloreje, Drejtori Ekzekutiv i AKBN-se merr masat per ristrukturimin e grupit.

14. Ne rast konstatimi te mungeses se kategorise se licensave perkatese te studios projektimit, projekt propozimi dhe/ose projekt zbatimi nuk do te trajtohet nga grupi i oponences teknike dhe i kthehet Autoritetit Kontraktor (METE).

## Neni 8

### Tarifat e kryerjes së opionences teknike

1. Tarifat per opionencen teknike te projekteve do te jene ato te përcaktuara sipas VKM nr.363, date 18.07.2002 "Per vendosjen e opionences teknike per projektet e ndertimit te objekteve", te ndryshuar.
2. Ne baze te njoftimit sipas nenit 5 pika 5 te kësaj rregulloreje, subjektet përpara kryerjes se opionences teknike do te kryejne ne AKBN pagesen sipas tarifave perkatese.

Kjo rregullore hyn ne fuqi me miratimin e saj nga Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetike